

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR ENERGINË ”

Qëllimi Mbështetja e politikës dhe prioriteteve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Pjesë e rëndësishme është edhe ruajtja e mjedisit nga efektet negative për shkak të zhvillimit të sektorit energjetik, diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet në këtë sektor. Nxitja dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme si faktor për rritjen e sigurisë së furnizimit. Në terma konkrete ky program parashikon të arrijë furnizimin e pandërprerë të konsumatorit me energji elektrike. Për vitin 2017, objektivat e këtij programi buxhetor janë:


- Komisionimi, marja në dorëzim dhe oponenta e HEC-ve të vogla, si dhe hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së.
- Studim për hartimin e rregullores për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet, si dhe rishikimi i kushteve dhe normave teknike në aktivitetet dhe infrastrukturën e furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure .
- Auditimi dhe vendosja e skemës detyruese për eficientë të energjisë në 5-8 konsumatorët e mëdhenj publike sipas ligjit 124/2015 për EE dhe Funksionimi i Agjencisë për Eficencën e Energjisë sipas ligjit 124/2015.
- Krijimi i kushteve për ndërtimin e një infrastrukture ligjore të sigurtë për energjitë bërthamore.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për fushën e energjisë, si atë elektroenergjetike, energjisë së rinovueshme dhe hidrokarburet për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për vitin 2017 shpenzimet në total për këtë program janë realizuar në masën 91 %. Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKOB, AKBN si dhe Agjencia e Eficencës së Energjisë.

Ne tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë sintetike në nivel programi plani i rishikuar dhe realizimi në vlerë dhe përqindje të shpenzimeve korrente dhe të shpenzimeve kapitale për periudhën Janar –Dhjetor 2017.

04320	Mbështetje për Energjinë	Plani Vjetor rishikuar 2017	Fakti 8/m 2017	% e realizimit
1.	Shpenzime Korrente	65.247	59.594	91.3%
1.1	<i>Personeli</i>	1.766	665	38%
1.2	<i>Operative</i>	63.482	58.929	93%
2	Shpenzime kapitale	127.987	116.740	91%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	124.987	46.740	37%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	3.000	70.000	
	TOTALI	193.234	176.334	91%

Grafikisht realizimi i planit të shpenzimeve në total të programit 04320 paraqitet si më poshtë :



Duke qenë se sektori energjetik është konsideruar si një sektor i një rëndësie të vecantë, puna është përqëndruar në përgatitjen e politikave në koherencë dhe cilësi, kryerjen në kohë të studimeve dhe oponentëve të nevojshme në mbështetje të politikbërjes si dhe krijimit të kushteve të favorshme me synim orjentimin e profesionistëve dhe bizneseve drejt zbatimit të politikave për eficientësinë e energjisë në Shqipëri. Kjo gjë vërehet dhe nga niveli i kënaqshëm i realizimit të shpenzimeve si në vlerë ashtu dhe referuar faktit.

Realizimi i fondeve buxhetore të programit në nivel produkti. Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i fondeve buxhetore të programit në nivel produkti .

Grupi	Ministria e Energjise dhe Industrise	Kodi	04320
Programi	" Mbeshtetje per Energjine "	Titulli	
Kodi i		Plani i Buxhetit 2017	Fakti 8-mujori i parë 2017
Rezultatit	Emri i Rezultatit		
A	Rregullore	1.500	750
B	Raport	1.000	670
C	Raport Monitorimi, Oponence dhe marrje ne dorezim	11.100	7215
E	Bilanci energjetik I prodhimit dhe konsumit te enrgjise	6.000	6020
F	Studim	1.000	670
G	Studim	1.500	1005
I	Rimbursim TVSH (Qyteti Studentit)	370.000	41.592
J	Rimbursim TVSH (Galet)	129.000	64.161
R	Mbulim TVSH (TAP)	140.000	142130
T	Infrastruktura Rrugore	1.352.000	1.351.200
V	Pagese TVSH (NjmP)	100.100	30.010
W	Arbitrazh	84.000	77.000
X	Infrastruktura Ligjire per Energjine Berthamore	12.000	5.757
Y	Mbeshtetje Infrastruktura per krijim Institucioni	42.900	-
AG	Udhezues	5.000	3.350
AH	Rregullore dhe Evidenca	3.000	2.010

AI	Softwer	14.000	-
		2.274.600	1.731.540

Realizimi i buxhetit në nivel programi sic është theksuar dhe më sipër është i kënaqshëm afërsisht në masën 77 %, dhe kjo gjë vërehet në pjesën më të madhe të produkteve. Nga tabela e mësipërme konkludojmë se, për realizimin e objektivave buxhetore të programit janë planifikuar 17 produkte, nga të cilat produktet AI dhe Y janë paraqitur me nivel realizimi të ulët.

Produkti AI, ka të bëjë me projektin “Software kombëtar për certifikimin e ndërtesave sipas ligjit 116/2016 "Për Eficencën e Energjisë në Ndërtesa" e cila ka të bëjë me përgatitjen e një Software. Aktualisht nga rishikimi i projektit është evidentuar pamjaftueshmëri fondesh në 4-mujorin e parë gjë e cila është plotësuar nëpërmjet rialokimit të fondeve në 4- mujorin e dytë. Aktualisht janë pezulluar procedurat e tenderimit me VKM 482 datë 5.07.2017. Parashikohet që ky projekt të realizohet 100%

Produkti Y, ka të bëjë me projektin e krijimit të Agjencisë së Eficencës së Energjisë (AEE). Në fillim të vitit 2017 është miratuar vendimi për krijimin e AEE, dhe është në proces plotësimi i strukturës së institucionit, pas së cilës pritet të vijohet me implementimin e këtij projekti.

Në përgjithësi 15 produktet e tjera në këtë program paraqiten me një nivel të kënaqshëm realizimi që varion nga 50% deri në 100% të planit vjetor të rishikuar.